



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 21 Prot.

Durrës, më 8.1.2024

**VENDIM**

Nr 1, datë 8.1 2024

**"PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË GRANTIT TË MËSIMDHËNIES TË VITIT 2024, PËR UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", zbatim të ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit të përbashkët të MASR dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, Rregulloren Financiare të UAMD, shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit , "Për shpërndarjen e fondeve grant për mësimdhënie, për vitin 2024, relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Administrimit Financiar, vendimit të Senatit Akademik nr.1, datë 05.01.2024, Bordi i Administrimit

**VENDOSI:**

1. Të miratojë detajimin e Grantit të Mësimdhënies deri në miratimin përfundimtar të buxhetit të vitit 2024 në organet kolegjiale të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administratori dhe strukturat përgjegjëse, për ndekjen e procedurave të mëtejshme ligjore, në menyrë që fondet të jenë të disponueshme në Degën e Thesarit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BORDIT TE ADMINISTRIMIT**

Ada ALIAJ

